

V E N D I M
Nr.582, datë 12.8.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË NDARJEN ADMINISTRATIVO-TOKËSORE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Me propozimin e sekretarit të Shtetit për Pushtetin Lokal, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.269, datë 25.6.1992 "Për ndarjen administrativo-tokësore të Republikës së Shqipërisë", bëhen këto ndryshime:

"- Komuna Bushtricë në rrethin e Kukësit të ndahet në tri komuna:

1. Komuna e Kalisit, me qendër në fshatin Kalis, e përbërë nga fshatrat Kalis, Gurrë, Pralisht, Gështenjë dhe Kodër-Gështenjë.

2. Komuna e Bushtricës, me qendër në Palushë, e përbërë nga fshatrat Bushtricë, Palushë, Gjegie, Matranzh, Baruq, Shpat dhe Vile.

3. Komuna Gryka e Cajes me qendër në fshatin Fshat, e përbërë nga fshatrat Fshat, Shkinak, Caj dhe Buzëmadh.

- Bashkia Konispol në rrethin e Sarandës të ndahet në:

1. Bashkia Konispol, e përbërë nga qyteti Konispol dhe fshati Çiflik.

2. Komuna Markat me qendër në fshatin Markat, e përbërë nga fshatrat Markat, Ninat, Shalës, Vervë, Dishat dhe Janjar.

- Komuna Selenicë në rrethin e Vlorës të ndahet në:

1. Bashkia Selenicë, e përbërë nga qyteti Selenicë.

2. Komuna Armen, me qendër në Armen, e përbërë nga fshatrat Armen, Mesarak, Karbunarë, Romës, Treblovë dhe fshatrat Picar dhe Lubonjë që shkëputen nga komuna Shushicë.

- Komuna Shllak në rrethin e Shkodrës të ndahet në dy komuna:

1. Komuna Shllak, me qendër në Vukjakaj, e përbërë nga fshatrat Vukjakaj-Gegaj, Palaj, Bene, Kroni i Madh, Barcolli, Vukaj dhe Ukbibaj.

2. Komuna Temal, me qendër në Koman, e përbërë nga fshatrat Koman, Gusht, Qerret, Arrë, Vile, Telum, Kllogjen, Malagji, Kajvall, Toplan dhe Serme.

- Komuna Bushat në rrethin e Shkodrës të ndahet në dy komuna:

1. Komuna Bushat, me qendër në Bushat, e përbërë nga fshatrat Bushat, Shkieze, Plezhë, Kosmac, Stajke, Ashtë, Rranxë, Fshati i Ri, Mali i Jushit, pa lagjen Hoten, Plepan, Melgush.

2. Komuna Barbullush, me qendër në Barbullush, e përbërë nga fshatrat Barbullush, Kukel dhe lagja Hote e Malit të Jushit.

- Bashkia Këlcyrë në rrethin e Përmetit të ndahet në:

1. Bashkia Këlcyrë, me qendër në Këlcyrë, e përbërë nga qyteti Këlcyrë dhe fshatrat Fshat-Këlcyrë, Mbrezhdan, Malëshovë, Limar dhe Leskaj.

2. Komuna Dishnicë, me qendër në Këlcyrë, e përbërë nga fshatrat Bedyqas Tolarë, Panarit, Riban, Varibobë, Kuqan, Mërtinjë, Xhanaj, Bënjë, Fratar, Senican, Katundishtë, Leskovec, Gerdas dhe Kodrishtë.

Shkëputen nga Bashkia Këlcyrë, fshatrat Agrovë, Grabovë e Pacomit dhe kalojnë me komunën Qendër.

- Komuna Qendër në rrethin e Përmetit të ndahet në dy komuna:

1. Komuna Qendër, me qendër në Piskovë, e përbërë nga fshatrat Piskovë, Kosinë, Kutal, Buhal, Rapckë, Pacomit, Grabovë, Argovë, Raban, Alipostivan, Odrëçan, Borrockë, Pagri, Kosovë, Hotovë, Gosnisht e Mokricë-Zleush.

2. Komuna Petran, me qendër në Petran, e përbërë nga fshatrat Petran, Kaludhë, Gjinkar, Bënjë-Novoselë, Ogdunan, Delvinë, Lipivan-Trebozisht, Tremisht, Lupckë, Bodar, Qilarisht, Leshnicë, Leusë, Lipë dhe Badlonjë.

Komuna Kutalli në rrethin e Beratit të ndahet në dy komuna:

1. Komuna Kutalli, me qendër në Kutalli, e përbërë nga fshatrat Kutalli, Pobrat, Sqepur, Protoduar, Rërez-Kunarak, Drenovicë, Samaticë, Goriçan, Goriçan-Çlirim dhe Malas-Breg.

2. Komuna Cukalat, me qendër në Cukalat, e përbërë nga fshatrat Cukalat, Donofrosë, Slanicë, Allambrez, Krotinë dhe Cetë.

- Komuna Fushë-Arrëzi në rrethin e Pukës të ndahet:

1. Bashkia Fushë-Arrëzi, me qendër në qytetin Fushë-Arrëzi, e përbërë nga qyteti Fushë-Arrëzi dhe fshatrat fshat Fushë-Arrëzi, Micojë dhe Lumardh.

2. Komuna Qafë-Mali, me qendër në Qafë-Mali, e përbërë nga fshatrat Qafë-Mali, Kryezi, Orosh, Lajthizë, Lumbardhë, Taç, Srriqe, Armiraj dhe Mollëkuqe.

3. Komuna Rrapë, me qendër në Rrapë, e përbërë nga fshatrat Rrapë, Mece, Kabash, Buhot, Blinisht, Bicaj, Breg dhe Lumzi.

- Bashkia Përrenjas në rrethin e Librazhdit të ndahet në:

1. Bashkia Përrenjas, e përbërë nga qyteti Përrenjas dhe fshatrat Rashtan e Përrenjas-Fshat.

2. Komuna Rrajcë me qendër në Rrajcë, e përbërë nga fshatrat Rrajcë, Sutaj, Skënderbej, Bardhaj, Katjel, Kotodesh dhe Urakë.

- Bashkia Sarandë në rrethin e Sarandës të ndahet në:

1. Bashkia Sarandë e përbërë nga qyteti Sarandë dhe fshatrat Gjashtë, Metoq dhe Shelegar.

2. Komuna Ksamil, me qendër në Ksamil, e përbërë nga fshati Ksamil.

Komuna Aliko do të ketë nën juridiksionin e saj edhe fshatin Çukë të Bashkisë Sarandë. Komuna Aliko të kalojë nga rrethi i Delvinës në rrethin e Sarandës.

- Në numrin e punonjësve të sekretarit Shtetëror të Pushtetit Lokal shtohen 8 punonjës me një fond page prej 228,8 mijë lekësh për periudhën dymujore nëntor-dhjetor 1996. Për vitin 1997 efekti i shtesës së numrit të punonjësve të llogaritet në buxhetin e vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Aleksandër Meksi